



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçilanit
Opština Gnjilane
Municipal Gjiçilane
Gilan Belediyesi

DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

Bazuar në Rregulloren e Ministrisë së Financave Nr.: 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, dhe në Rregulloren së Komunës së Gjiçilanit për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve Nr.016-126422, dt.29.12.2016, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport-Gjiçilane shpall:

THIRRJE PUBLIKE

Për anëtarë të komisionit për vlerësimin e projekt propozimeve të OJQ-ve dhe individëve të pranuar sipas thirrjes publike të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport

Bazuar në Rregulloren e Ministrisë së Financave Nr.: 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat financimit publik të OJQ-ve në Nenin 8, paragrafin 3.2 që pjesë e çdo Komisioni Vlerësues për vlerësimin e projekt propozimeve të OJQ-ve të pranuar sipas thirrjes publike duhen të jenë dy përfaqësues nga grupi i ekspertëve të jashtëm, duke përfshirë një përfaqësues të OJQ-ve.

Për këtë qëllim DKRS-ja fton të gjithë të interesuarit që të aplikojnë për të qenë pjesë në cilësinë e anëtarit të Komisionit Vlerësues për të vlerësuar projekt propozimet e dorëzuara nga OJQ-të, sipas thirrjes publike në DKRS të datës 28.02.2023 të publikuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

Të gjithë kandidatët të cilët nuk janë nën hetime apo me procedurë penale dhe që kanë përvojë në shoqëri civile me përparësi nga OJQ-të që merren me fushën e Kulturës mund të aplikojnë për pjesëmarrje në Komisionin Vlerësues në cilësi të:

1. Një përfaqësues nga OJQ-të.
2. Një përfaqësues në cilësinë e ekspertit.

Të drejtë aplikimi kanë:

- Të angazhuar në Organizatat jo-qeveritare aktive që veprojnë në Komunën e Gjilanit ;
- Ekspert të pavarur të cilët kanë përvojë pune që ndërlidhet me hartimin dhe menaxhimin e projekteve në fushën e Kulturës.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:

- Duhet të kenë të diplomë universitare.
- Të ketë përvojë në hartimin dhe menaxhimin e projektetve të OJQ-ve kulturore.
- Të mos jenë të emëruar politik, shërbyes civil apo pozita të ngjajshme në administratën shtetërore.

Kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Një CV.
- Përfaqësuesi nga OJQ-të duhet të dorëzoj një letër nominimi nga udhëheqësi i OJQ-së në të cilën dëshmohet se aplikuesi është i punësuar apo i angazhuar në organizatë.
- Përfaqësues në cilësinë e ekspertit duhet të kenë diplomë universitare (të artit).

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen, në adresën e mëposhtme:Komuna e Gjilanit

Qendra për shërbim me qytetarë, ndërtesa e Soliterit, kati I.

Afati i apikimit nga data 28.02.2023 deri më datën 14.03.2023

Një Komision i themeluar nga DKRS-ja do t'i vlerësoj të gjitha aplikacionet e pranuar dhe kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara përmes kësaj thirrje publike që do të jenë pjesë e Komisionit Vlerësues për subvencionimin e OJQ-ve dhe Individëve për vitin 2023.

Drejtori: Kushtrim Zeqiri

